



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:109305

Datë: 17.11.2020

Numri i dokumentit: 01278034

P.nr.101/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Sabrije Rraci, me sekretaren juridike Shere Desku, në lëndën penale kundër të pandehurit H. (M.) B., nga fsh.Komuna e, me qka ka kryer „Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktakuzë-Më Propozim për shqiptimin e Urdhërit Ndëshkimor nga Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.970/2020, të datës 03.09.2020, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **17.11.2020** mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: H. B., i lindur me dt. , në më banim në fshatinK., nga i ati M. dhe e ëma Gj., e gjinisë B., Komuna e, i martuar ku edhe tani banon, i martuar, I identifikuar me nr. Personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mire se:

Në kohë të pavërtetuar e gjerë me datën: 03.08.2018 në cilësi të shfrytëzuesit të energjisë elektrike e në kundërshtim me ligjin në shtëpinë e tij në adresën fsh.K., me qëllim që vetes të I sjellë pasuri në mënyrë të kundërligjshme, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar ka vjedh energji elektrike, në atë mënyrë që:

Me datë 03.08.2018, gjatë kontrollit të bërë nga ana e ekipës së-it, ekipa e-it ka hasur tek i pandehuri lidhje jashtë pikes matëse, ashtu që në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energji elektrike me aparatet e cekura në Pprocesverbalin nr.2169898 të dt. 03.08.2018, e duke I shkaktuar të dëmtuarit dëm material në vlerë prej 101.52 Euro.

Me qka ka kryer veprën penale „**vjedhje e shërbimeve**” nga neni 314 par 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.970/2020, të datës 03.09.2020.

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, nenit 46, 73, 74 dhe nenit 250 KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit ia shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në lartësinë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë dënimi me gjobë të pandehurit i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

OBLIGOHET: I pandehuri që ti paguajë shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

UDHËZOHET: Përfaqësuesi i pales së dëmtuar-si që kërkesën pasurore juridike ta udhëzoi në contest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar Kërkesën për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor me numër PP/II.nr.370/2020, të datës 03.09.2020, kundër të pandehurit H. B., për shkak të veprës penale „vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par 1 të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do të shqiptojë dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë nga: Procesverbalit të kontrollimit detal të njehsorit të energjisë elektrike nr.2169898, shifra 42746 dates 03.08.2018,Info te konsumatorit; Fatuara mbi denimin e shkatuar nr.DPEHP 1812550 me dt.07.08.2018 Dy (2) Fotografi të vendit të ngjarjes;

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryejë veprën penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe par.2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në contest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së. Me sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË KLINË,
P. nr. 101/2020 Më datën 17.11.2020**

Sekretarja juridike,

Gjyqtarja

Shere Desku

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar
Kundërshtimi në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit
të të njëjtit kësaj Gjykate, në të kundërtën po që se i
pandehuri nuk ushtrojnë kundërshtim, aktgjykimi do të
marrë formën e prerë.